



Prishtinë, 27 dhjetor 2013
Kodi i ZRRE-së: V_601_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, dhe Dispozitat e Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 24, paragrafi 5 të Ligjit për Energjinë elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 24.12.2013 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Rregullat e Tregut”,

në seancën e mbajtur me datë 27 dhjetor 2013, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHEN “Rregullat e Tregut”

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 24.12.2013 ka pranuar kërkesën për aprovim të versionit final të dokumentit “Rregullat e Tregut” të KOSTT SH.A. Dokumenti është punuar në bazë të Dizajnit të Tregut dhe ka qenë në diskutim publik për një kohë të gjatë.
- Hartimi i Rregullave të tregut ka filluar nga fundi i vitit 2011, janë mbajtur shumë takime, dhe dokumenti ka pësuar ndryshime e përmirësime si dhe janë dhënë komente të shumta. Gjatë procesit të hartimit të Rregullave të Tregut kanë qenë të involvuar akterët relevant të sektorit të energjisë përfshirë edhe përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- ZRRE ka qenë e kyçur gjatë tërë kohës së hartimit të dokumentit dhe ka dhënë komentet e veta si drejtpërdrejt në takimet e mbajtura, por edhe në formë të shkruar.
- KOSTT ka bërë kërkesën për aprovim për herë të parë me 22.10.2013. Por në ndërkohë dokumenti është dërguar në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për komentim, si dhe janë bërë komente shtesë edhe nga ZRRE, kështu që dokumenti ka pësuar ndryshime tjera.
- Me datë 24.12.2013 KOSTT ka dorëzuar versionin final për aprovim në ZRRE.
- Dokumenti Rregullat e Tregut është i rëndësishë së veçantë, dhe ZRRE konsideron se i përmbush kriteret për aprovim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti Rregullat e Tregut.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar